

**LIGJ Nr.9223, date 29.4.2004**

**PER DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NE LIGJIN NR.8530, DATE 23.09.1999  
"PER SHERBIMIN POSTAR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE**

Ne mbështetje te neneve 78 dhe 83 pika 1 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

**VENDOSI:**

Ne ligjin nr. 8530, date 23.9.1999 "Për shërbimin postar ne Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Ne nenin 3 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Pika 14 e nenit 3 ndryshohet si me poshtë:  
"14. "Shërbime te rezervuara" nënkupton shërbimet e kryera ekskluzivisht nga operatori publik i postave, për te përmbushur detyrimin e shërbimit baze për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve te korrespondencës se brendshme, me çmim dhe kufi peshe, siç përcaktohet ne vendimin e Këshillit te Ministrave."
2. Pas pikës 18 shtohen pikat 19 dhe 20 si me poshtë:  
"19. "Licence individuale" nënkupton te drejtën qe i jepet çdo subjekti juridik, vendas ose i huaj, qe plotëson kërkesat e legjislacionit shqiptar për shërbimet postare, për ofrimin e shërbimeve te tjera nga ato te rezervuara, qe përfshihen ne shërbimin baze postar.  
"20. "Licence e përgjithshme" nënkupton te drejtën qe i jepet çdo subjekti fizik ose juridik, vendas apo i huaj, qe plotëson kërkesat e legjislacionit shqiptar për shërbimet postare, për ofrimin e shërbimeve te tjera nga ato te rezervuara, qe nuk përfshihen ne shërbimin baze postar. "

**Neni 2**

Shkronja "b" e pikës 1 te nenit 11 ndryshohet si me poshtë:

"b) te këtë te drejtën e transportimit te objekteve te thjeshta te postes se letrave te brendshme, ne peshën qe do te përcaktohet ne vendimin e Këshillit te Ministrave. Këtu përfshihen dhe objektet e postes se drejtpërdrejte."

**Neni 3**

Titulli i kreut V behet "Licencat" dhe titulli i nenit 16 behet "Licenca individuale"

#### Neni 4

Neni 17 i ligjit ndryshohet si me poshtë:

"Neni 17

Licencat e përgjithshme

1. Shërbimet e tjera postare, qe nuk përfshihen ne shërbimin baze postar, ushtrohen pas dhënies se licencës se përgjithshme nga ministri.
2. Procedura për dhënien e licencës se përgjithshme përcaktohet nga ministri.
3. Një licence e përgjithshme mund t'i jepet një personi fizik ose juridik, i cili:
  - a) plotëson kërkesat themelore te konfidencialitetit, te sigurisë dhe te mbrojtjes se te dhënave, si dhe respekton te drejtat ekskluzive qe i jepen operatorit publik;
  - b) plotëson kërkesat e nevojshme, sipas legjislacionit ne fuqi, për te ushtruar veprimtarinëpostare.
4. Ofruesi i shërbimit është i detyruar te njoftoje DPPT-ne për pezullimin dhe përfundimin e veprimtarisë se tij te paktën 30 dite para marrjes se një veprimi te tille.
5. Ofruesi i shërbimit duhet t'ia paraqesë tarifat për dijeneri DPPT-se te paktën 15 dite para vënies se tyre ne zbatim, si dhe te japë çdo informacion, qe i kërkohet nga ajo për kryerjen e funksioneve te saj.
6. Një ofruer i shërbimit, qe ofron shërbimet ne baze te një licence individuale, sipas nenit 16 te këtij ligji, nuk ka nevojje për licence te përgjithshme nga ministri, siç parashikohet ne këtë nen."

#### Neni 5

Ne te gjithë tekstin e ligjit, fjala "licence" zëvendësohet me fjalët "licence individuale" dhe fjala "leje" zëvendësohet me fjalët "licence e përgjithshme".

#### Neni 6

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr .4230, date 26.5.2004 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë, Alfred Moisiu